



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 52 prot.

Kamëz më 11.04.2023

V E N D I M

Nr. 40, datë 11.04.2023

P Ë R

“MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO FAMILJE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË PËR VITIN 2023”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 11.04.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.28 Datë 11.04.2023 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKM nr. 459 datë 03.09.2019 “Rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim”; Udhëzim nr.31 dt.18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti shtetit për programet e strehimit”; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.4 datë 17.01.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”; Vendimit nr.141 datë 25.11.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Manualit për programin e subvencionit të qirasë për Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”, VKB nr.12 datë 15.02.2023 “Mbi miratimin e listës së familjeve që nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë”, VKB nr 163 dt.21.12.2022 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2023, 2024, 2025”, shkresës me nr. Prot.13 dt. 04.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.3217 Prot datë 11.04.2023, Procesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot nr.3217/1 Prot datë 11.04.2023, Këshilli Bashkiak Kamëz,

V E N D O S I:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

1. Trajtimin me subvencionimin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Rakordimin e vlerave të qirasë mujore për 14 familje sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të hiqen nga programi i Strehimit Social 3 familje, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë tetë mujore duke filluar nga data 01.05.2023 deri në datën 31.12.2023,
5. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 do të përballohen në raportin 100% nga *buxheti i Bashkisë Kamëz*.
6. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

